



Group of States against Corruption
Groupe d'États contre la corruption

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Miraturar më: 18 Mars 2016

Publikuar më: 15 Prill 2016

Public

GrecoRC4(2016)6

RAUNDI I KATËRT I VLERËSIMIT

Parandalimi i korrupsionit në lidhje me anëtarët e
parlamentit, gjyqtarët dhe prokurorët

RAPORT PËR VLERËSIMIN E PËRPUTHSHMËRISË

SHQIPËRIA

Miraturar nga GRECO në Takimin e tij të 71-të Plenar
(Strasbourg, 14-18 Mars 2016)

I. HYRJE

1. Raporti për Vlerësimin e Përputhshmërisë vlerëson masat e ndërmarra nga autoritetet e Shqipërisë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Katërt të Vlerësimit për Shqipërinë, i miratuar në Takimin e 63-të Plenar të GRECO-s (28 Mars 2014) dhe i publikuar më 27 Qershor 2014, mbas autorizimit nga Shqipëria ([GrecoEval IV Rep \(2013\) 9E](#)). Raundi i Katërt i Vlerësimit nga GRECO trajton "Parandalimin e korrupsionit në lidhje me anëtarët e parlamentit, gjyqtarët dhe prokurorët".
2. Siç kërkohet nga Rregullat e Procedurës së GRECO-s, autoritetet e Shqipërisë paraqitën një Raport Situate në lidhje me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve. Ky raport u mor më 29 Janar 2016 dhe u plotësua më tej me informacionin me shkrim të paraqitur më 9 Mars 2016. Të dyja shërbyen si një bazë për Raportin e Vlerësimit të Përputhshmërisë.
3. GRECO përzgjodhi Qipron dhe "ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë" për të caktuar Reporterët për procedurën e vlerësimit të përputhshmërisë. Reporterët e caktuar ishin Znj. Theodora PIPERI-CHRISTODOULOU, Avokate e Republikës, Zyra Ligjore e Republikës, në emër të Qipros, dhe Znj. Aneta ARNAUDOVSKA, Drejtoreshë e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, në emër të "ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë". Në përpilimin e Raportit të Vlerësimit të Përputhshmërisë ato u ndihmuan nga Sekretariati i GRECO-s.
4. Raporti i Vlerësimit të Përputhshmërisë vlerëson zbatimin e secilit rekomandim më vete dhe jep një vlerësim të përgjithshëm të nivelit të pajtueshmërisë së anëtarit me këto rekomandime. Zbatimi i çdo rekomandimi të vonuar (të zbatuar pjesërisht apo të pazbatuar) do të vlerësohet në bazë të një tjetër Raporti Situate që duhet dorëzuar nga autoritetet 18 muaj pas miratimit të këtij Raporti të Vlerësimit të Përputhshmërisë.

II. ANALIZA

5. Në raportin e tij të vlerësimit GRECO ka adresuar 10 rekomandime për Shqipërinë. Përputhshmëria ndaj këtyre rekomandimeve trajtohet më poshtë.

Parandalimi i korrupsionit në lidhje me anëtarët e parlamentit

Rekomandimi i.

6. *GRECO rekomandonte përmirësimin e transparencës së procesit legjislativ nëpërmjet i) sigurimit të zbatimit në kohën e duhur të kërkesës, sipas Rregullave të Procedurës, për të botuar në faqen zyrtare të Kuvendit të projektligjeve, përfshirë propozimin fillestar dhe amendamentet; dhe ii) rregullimit të kontakteve të deputetëve me lobistë e palë të tjera të treta që kërkojnë të ndikojnë procesin legjislativ.*
7. Në lidhje me pjesën (i) të rekomandimit, autoritetet e Shqipërisë shpjegojnë se në Shkurt 2014, Byroja e Kuvendit ka miratuar një Vendim për "Rregullimin e funksionimit të faqes së internetit të Kuvendit". Në bazë të këtij vendimi, projektligjet dhe raportet shoqëruese shpjeguese duhen botuar menjëherë, "pas njoftimit të seancës së radhës të planifikuar". Autoritetet shprehen se kjo gjë ka një ndikim të drejtpërdrejtë tek programi i punës së komisioneve të përhershme ku projektligjet referohen e debatohen fillimisht. Çdo komision punon sipas një kalendarit tre-javor të harmonizuar me agjendën e seancës plenare të Kuvendit. Rrjedhimisht, në rast se diskutimi i një projektligji fillestar është futur në kalendarin e një komisioni dhe kalendarin është miratuar, atëherë projektligji duhet

botuar menjëherë në faqen e internetit të Kuvendit. Autoritetet këmbëngulin se amendamentet pasuese botohen, po ashtu, menjëherë: pas debatit në komision mbi projektligjin fillestar ose prezantimit para tij të amendamenteve. Po ashtu, që nga Janari 2016, Kuvendi ka një faqe të re zyrtare interneti (www.parlament.al), ku botohen të gjithë dokumentet parlamentare. Në seksionin "Dokumente", mund të gjendet i gjithë informacioni mbi projektligjet, vendimet, rezolutat, deklaratat dhe raportet, dhe në mënyrë specifike, nën nëntitullin "Projektligje", paraqiten projektligjet e depozituara nga Këshilli i Ministrave dhe deputetë si dhe të gjitha të dhënat në lidhje me to (d.m.th. statusi, raportet shoqëruese, raportet e komisioneve të përhershme, amendamentet e propozuara nga deputetë, rezultatet e votimit dhe në fund tekstet e miratuara).

8. Raporti i referohet më tej edhe një platforme digjitale E-Parliament, e cila është në fazën e parë të realizimit. Duke shtruar rrugën drejt digjitalizimit të plotë të veprimtarive të Kuvendit, platforma lehtëson ekzekutimin e detyrave rudimentare nga deputetët dhe stafi i Kuvendit dhe ka për qëllim forcimin e mëtejshëm të transparencës së procesit legjislativ.
9. Duke iu kthyer pjesës (ii) të rekomandimit, në Nëntor 2014, Byroja e Kuvendit miratoi një Manual "Mbi pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes së Kuvendit". Qëllimi i Manualit është i trefishtë: 1) të nxisë dhe rregullojë pjesëmarrjen e shoqërisë civile, ekspertëve dhe grupeve të interesit¹ në procesin ligjvënës; 2) të përcaktojë udhëzimet për përgatitjen dhe mbajtjen nga komisionet parlamentare të seancave dëgjimore publike, në përputhje me Nenin 36¹ të Rregullave të Procedurës; dhe 3) të kontrollojë dhe monitorojë kontaktet e deputetëve me palët e treta të interesuara. Veç kësaj është caktuar një Koordinator për Grupet e Interesit (një pjesëtar i administratës) për të lehtësuar bashkëpunimin e Kuvendit me grupet e interesit, shoqërinë civile dhe partnerët socialë.²
10. Veç kësaj, në faqen elektronike të Kuvendit është ngritur një Regjistër Elektronik i Shoqërisë Civile, i lidhur me Sistemin e Integruar të Tatimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ku janë të regjistruara të gjitha OJQ-të. Regjistri është i hapur për të gjitha OJQ-të dhe sot aty mund të identifikohen rreth 2 740 organizata të shoqërisë civile përmes numrit të taksave, personave të kontaktit dhe objektit të aktivitetit. Autoritetet theksojnë se Regjistri ka përmirësuar ndërveprimin e Kuvendit me publikun dhe shpesh përdoret, p.sh., për dërgimin e ftesave për seancat publike. Autoritetet theksojnë se tashmë janë rregulluar të gjitha kontaktet e deputetëve me palët e treta. Procedurat për kontaktimin e deputetëve, "dërgimin e rekomandimeve" dhe për të marrë pjesë në procesin legjislativ tashmë janë parashikuar me hollësi dhe standardizuar për të gjithë komisionet, dhe botimi i informacionit përkatës në faqen elektronike të Kuvendit e ka bërë më transparent procesin legjislativ.
11. Në lidhje me pjesën (i) të rekomandimit, GRECO është i kënaqur me miratimin nga Byroja e Kuvendit të një Vendimi që sqaron se kur duhen publikuar projektligjet në fazën fillestare. Ai mirëpret po ashtu përdorimin e gjerë të teknologjisë së informacionit në punën parlamentare dhe futjen në përdorim të instrumenteve të afta për grumbullimin dhe organizimin automatik të informacionit duke adresuar kështu shqetësimin tjetër, në bazë të këtij rekomandimi, për të siguruar zbatimin në kohë të kërkesës, sipas Rregullave të Procedurës, për publikimin edhe të ndryshimevetë projekt-akteve ligjore. GRECO kujton se, në kohën e vizitës

¹ Manuali përmban përkufizime të "shoqërisë civile", "ekspert", "grup interesi" dhe "grup tjetër interesi".

²Koordinatori *inter alia* siguron informacion në lidhje me projekt-aktet ligjore që duhen analizuar dhe diskutuar nga komisionet parlamentare, kërkon opinione nga palët e treta të interesuara, shpërndan informacion mbi mbledhjet e komisioneve dhe fton palët e treta të interesuara, kur kjo gjykohet e arsyeshme nga kryetarët e komisioneve, informon palët e treta të interesuara në lidhje me legjislationin e miratuar e nëse sugjerimet janë marrë parasysh apo janë hedhur poshtë, për çfarë arsye.

vlerësuese, pavarësisht rregullave për zbulim të informacionit, gjurmimi i ndryshimeve të projektligjeve - gjatë procesit të shqyrtimit - rezultonte i pamundur dhe se situata nuk ndreqej nga aksesit i publikut në procesverbalin e detajuar të seancave plenare dhe të komisioneve.³ Megjithëse GRECO arrin në përfundimin se kjo pjesë e rekomandimit tashmë është zbatuar në nivel të kënaqshëm, ai inkurajon autoritetet ta mbajnë nën vëzhgim këtë çështje, duke mbajtur parasysh se, ndërkohë që në shumë raste kanë qenë efektive, instrumentet e IT-s kërkojnë dhënien e të dhënave parlamentare në format *open data* dhe të lexueshme nga makina, gjë që në kontekste të caktuara mbetet një sfidë.

12. Në lidhje me pjesën (ii) të rekomandimit, GRECO njeh se Kuvendi ka vendosur disa rregulla dhe ka krijuar disa instrumente (një regjistër të OJQ-ve, Koordinatorin e Grupeve të Interesit) për të menaxhuar më mirë marrëdhëniet e deputetëve me përfaqësuesit e interesave publikë dhe privatë, në kontekstin e procesit legjislativ, dhe për rritjen e transparencës në këtë fushë. Pavarësisht kësaj, tërësia e masave të raportuara duket se është e orientuar për nga rregullimi i sektorit jo-qeveritar dhe, veçanërisht, i shoqërisë civile, kryesisht në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në dëgjesat publike. Sa për "anën tjetër" të procesit, rregullat e reja janë disi të fragmentuara. Ato janë të zbatueshme për kontaktet zyrtare të Kuvendit dhe të komisioneve të tij (p.sh. në kuadrin e seancave publike apo kur kërkohet opinioni i ekspertëve të jashtëm) por jo për ato të grupeve parlamentare. Sa për deputetët individualisht, nuk është përcaktuar sjellja e pritur prej tyre dhe kontaktet e tyre, edhe nëse kanë një ndikim të drejtpërdrejtë mbi legjislacionin e debatuar në parlament, nuk janë subjekt i sistemit të njoftimit apo i rregullave të zbulimit (apo kufizimit) të informacionit dhe është e paqartë nëse kjo gjë do të korrigojë nga Kodi i Sjelljes i ardhshëm për deputetët dhe si (shih për këtë *rekomandimin ii*). Nisur nga sa më sipër, ndjehet se konfirmimi nga ana e autoriteteve në lidhje me kontrollin dhe monitorimin e duhur të ndërveprimit të deputetëve me palët e treta të interesuara në kontekstin e procesit legjislativ është i pajustificuar. GRECO arrin në përfundim duke rikujtuar se fokusi i Raundit të Katërt të Vlerësimit është në lidhje standardet e zbatueshme për deputetët, jo për ata që llojnë me ta. Për këtë arsye, ky rekomandim konsiderohet si pjesërisht i zbatuar.
13. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi i është zbatuar pjesërisht.

Rekomandim ii.

14. *GRECO rekomandonte që i) Kodi i Sjelljes për deputetët, parashikuar në Rregullat e Procedurës së Kuvendit, të përpunohet dhe të zbatohet siç duhet; dhe ii) deputetëve t'u ofrohet trajnim, orientim dhe këshillim për çështje të tilla si forma, mënyra dhe hapësira e kontakteve të lejueshme me grupet e interesit dhe lobistët, deklarimi ad hoc i rasteve të konfliktit të interesit, etika dhe parandalimi i korrupsionit në radhët e tyre.*
15. Në lidhje me pjesën (i) të rekomandimit, autoritetet e Shqipërisë shprehin se, në vitin 2014, mbështetur në një Urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, Departamenti i Shërbimit Ligjor, hartoi një Kod Sjelljeje për Deputetët. Qëllimi i Kodit, i cili mbështetet tek praktikën e mira ndërkombëtare, është i dyfishtë: caktimi i standardeve të duhura të sjelljes për deputetët gjatë ushtrimit të një funksioni publik dhe garantimi i transparencës dhe i përgjegjshmërisë së nevojshme për rritjen e besimit publik. Pasi të miratohet, Kodi do t'i bashkëngjitet si Shtojcë Rregullave të Procedurës së Kuvendit. Në Maj 2015, në Kuvend, për këtë çështje, u organizua një tryezë e rrumbullakët dhe në Dhjetor 2015, u ngrit një grup pune i përbërë nga përfaqësues të tre grupeve kryesore parlamentare me qëllim përmirësimin e projektit dhe forcimin e mekanizmit zbatues të Kodit. Kjo punë është ende në vazhdim.

³Shih. paragraf 26 i Raportit të Vlerësimit.

16. Duke kaluar tek pjesa (ii) e rekomandimit, flitet për një aktivitet trajnimi organizuar në 13 Nëntor 2014 nga Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Konfliktet e Interesit (ILDKPKI) për autoritetet/strukturat brenda institucioneve publike përgjegjëse për parandalimin, verifikimin dhe zgjidhjen e konflikteve të interesit në përputhje me ligjin përkatës⁴. Midis rreth 90 pjesëmarrësve, kishte edhe përfaqësues të Kuvendit (sekretariati). Aktiviteti u fokusua tek rezultatet e Raundit të Katërt të Vlerësimit të GRECO-s për Shqipërinë dhe trajtoi raste teorike dhe praktike të parandalimit dhe zgjidhjes së konflikteve të interesit si dhe rolin dhe funksionet e autoriteteve përgjegjëse.
17. GRECO merr parasysh diskutimet mbi projekt-Kodin e Sjelljes dhe shpreson që kjo punë do të vazhdohet me vendosmëri për të siguruar miratimin me shpejtësi të tij. GRECO njeh se drafti *inter alia* do të përcaktojë rregullat e përgjithshme të etikës dhe do të trajtojë çështje të tilla si konflikti i interesave, papajtueshmëritë, dhuratat, transparencja, konfidencialiteti dhe kufizimet e pas-punësimit. GRECO vëren gjithashtu se po përparohet edhe me negociatat ndër-parlamentare në lidhje me mekanizmin zbatues të Kodit. Ai arrin në përfundimin se pjesa (i) e rekomandimit është zbatuar pjesërisht. Sa i takon pjesës (ii) të rekomandimit, ajo mund të vlerësohet vetëm pasi Kodi të jetë miratuar dhe zbatuar në praktikë⁵.
18. Veç kësaj, edhe nëse kjo del jashtë fushës së interesit të këtij rekomandimi, GRECO vëren me interes reformën kushtetuese në zhvillim e sipër, që synon *inter alia* forcimin dhe garantimin e integritetit të zyrtarëve publikë shqiptarë, përfshirë deputetët, duke i bërë këta subjekt të kontrolleve të përgjithshme të integritetit. Në thelb, qëllimi i projektligjit "Mbi garantimin e integritetit të zyrtarëve publikë", i cili po diskutohet sëbashku me amendamentet kushtetuese, është parandalimi i zgjedhjes/ emërimit në poste zyrtare, dhe shkarkimi i zyrtarëve, të cilët janë dënuar për (një listë të gjatë) vepra penale, që janë subjekt i masave të sigurisë në Shqipëri apo jashtë, ose për të cilët pritet dhënia e një vendimi përfundimtar për kryerje të veprës penale të parashikuar në ligj. GRECO do të vlerësonte çdo informacion në lidhje me reformën dhe do të ishte veçanërisht kureshtar të mësonte nëse ndonjë nga deputetët aktualë apo të ardhshëm nuk do ta kalonin kontrollin e integritetit.
19. GRECO arrin në përfundimin se rekomandimi ii është zbatuar pjesërisht.

Rekomandim iii.

20. *GRECO rekomandon ngritjen brenda Kuvendit të një mekanizmi për njoftimin "rast pas rasti" të konflikteve të interesit nga deputetët, dhe që funksionimi i këtij mekanizmi t'i nënshtrohet monitorimit.*
21. Autoritetet e Shqipërisë dëshmojnë se, me qëllim parandalimin e konflikteve të interesit tek deputetët dhe marrjen prej tyre të njoftimeve "rast pas rasti" për ekzistencën e konflikteve të tilla, në mars 2014, në Kuvend, me Urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm, u ngrit një "autoritet përgjegjës" në kuptimin e Ligjit për Parandalimin e Konflikteve të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike (LPKI). Dy persona nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Departamenti i Përfitimeve të deputetëve janë caktuar përkatësisht kryetar dhe anëtar i autoritetit. "Autoriteti" vepron në zbatim të LPKI-së dhe urdhrave të ILDKPIK-së dhe monitorohet nga ky i fundit. Autoritetet shpjegojnë më tej se, meqenëse

⁴Në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konflikteve të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike, autoritetet përgjegjëse në institucionet publike janë të mandatuara të mbështesin drejtpërsëdrejti, të këshillojnë, të orientojnë dhe trajnojnë zyrtarët publikë që kanë për detyrë të deklarojnë interesat dhe asetet e tyre private, në bazë të këtij Ligji dhe Ligjit për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive.

⁵GRECO është në dijeni të aktiviteteve promovuese të ILDKPIK-së në lidhje me të ashtuquajturin konflikt interesi "në vazhdim" dhe deklarin e pasurisë.

mekanizmi i njoftimit bazohet kryesisht tek deklarimi vullnetar, deri tani është bërë vetëm një deklarim *ad hoc* (një deputet nuk mori pjesë në një procedurë zgjedhjeje ku përfshihej bashkëshortja e tij, e cila ishte kandidatë për një post publik). Për këtë arsye, Kuvendi po konsideron aktualisht miratimin e një akti ligjor i cili do të detyronte deputetët të nënshkruajnë një deklaratë për mungesë të konfliktit të interesit përpara se të marrin pjesë në një mbledhje komisioni; një akt i tillë mund të ndalojë edhe votimin nga ana e një deputeti në lidhje me një pikë të agjendës, nëse ka një konflikt interesi.

22. GRECO mirëpret hapat konkretë të marrë për zbatimin e dispozitave të LPKI-së në lidhje me deklarimin dhe regjistrimin nga deputetët të konflikteve të interesit "rast pas rasti". Megjithatë, fakti që, nga Marsi 2014, është regjistruar vetëm një rast, përbën një burim shqetësimi. GRECO kujton se në kohën e vizitës së vlerësimit u konstatuan disa çështje problematike. Pikëpamjet e deputetëve të intervistuar ishin të ndryshme në lidhje me faktin nëse kapitujt që kishin të bënin me LPKI-në ishin të zbatueshëm për deputetët, cilat situata cilësoheshin si konflikte interesi "rast pas rast" në kontekstin e funksioneve të një deputeti, dhe tek cili autoritet duheshin raportuar konfliktet *ad hoc*. Ndërsa kjo e fundit tashmë është zgjidhur, duket se dy çështjet pararendëse meritojnë vëmendje të mëtejshme dhe sqarime të tjera, qoftë kjo përmes ndryshimeve ligjore në Rregullat e Procedurës, përshtatjeve në Kodin e ri të Sjelljes për deputetët apo përmes miratimit të një akti ligjor të veçantë siç sugjerohet më sipër. Gjithashtu, ofrimi i trajnimeve për "autoritetin përgjegjës" (shih paragrafi 16) nuk mund të konsiderohet diçka e mjaftueshme për sa kohë nuk përkthehet në udhëheqje, këshillim, mbështetje dhe trajnim për vetë deputetët gjatë gjithë mandatit të tyre (siç e kërkon edhe ligji). GRECO rithekson se deklarimi i konflikteve të interesit, përfshirë deklarimin *ad hoc*, shihet gjithmonë e më shumë si një kërkesë minimale për deputetët dhe si një dimension i rëndësishëm i parandalimit të korrupsionit. Ndaj GRECO nënvizon rëndësinë dhe urgjencën e adresimit të të gjitha çështjeve në pritje, në kuadër të këtij rekomandimi, për krijimin e një mekanizmi njoftimi të besueshëm dhe funksional për konfliktet e interesit "rast pas rasti".
23. GRECO arrin në përfundiminse rekomandimi iii është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi iv.

24. *GRECO rekomandon që përmbajtja e deklaratës së pasurisë së deputetëve të publikohet në një faqe interneti zyrtare dhe në kohën e duhur, duke i kushtuar vëmendjen e duhur privatësisë dhe sigurisë së deputetëve dhe personave të lidhur me ta, që janë subjekt i detyrimit për të raportuar.*
25. Autoritetet e Shqipërisë raportojnë një sërë masash të marra për zbatimin e këtij rekomandimi: 1) shfuqizimi i një tarife administrative për të pasur akses në formularin e deklarimit të pasurisë së deputetit; 2) rishikimi i ligjit të vitit 2014 "Mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, detyrimet financiare të zyrtarëve të zgjedhur dhe të disa zyrtarëve publikë" (LDKP) me efektin që, një deklaratë e dorëzuar mund të zbulohet përpara kontrollit të detyrueshëm paraprak dhe daljes së certifikatës së pajtueshmërisë nga ILDKPKI; dhe 3) rishikimi nga ILDKPKI i rregullave të brendshme në zbatim të një transparence më të madhe dhe zbatimit më me efektshmëri të Ligjit "Mbi aksesin në informacion" i cili *inter alia* përcakton një periudhë 15-ditore për t'iu përgjigjur çdo kërkesë për informacion.
26. Në kohën e raportimit, autoritetet vërejtën se ILDKPKI kishte marrë dhe u ishte përgjigjur 10 kërkesave për zbulim të formularit të deklarimit të pasurisë së deputetëve dhe se informacion mbi pasuritë e të gjithë deputetëve për periudhën 2003-2014 u ishte vënë në dispozicion palëve të interesuara dhe ishte publikuar prej tyre - i plotë apo si përmbledhje - në shtypin e shkruar apo në disa faqe interneti. Po ashtu nënvizohet se, megjithë volumin e madh të kërkesave për

"kopje të formularëve të deklaratës" të ardhura kryesisht nga media dhe shoqëria civile (jo vetëm për deputetët, por edhe për zyrtarë të tjerë me detyrimin për të bërë deklarinimin e pasurisë), ILDKPKI u është përgjigjur pozitivisht të gjitha kërkesave të tilla dhe brenda afatit kohor dhjetë-ditor, të përcaktuar në ligj. Dëshmi për këtë është mungesa e çdo lloj ankese.

27. GRECO merr parasysh informacionin e ofruar dhe mirëpret, veçanërisht, heqjen e shumë pengesave për zbulimin e formularëve të deklarinimit të pasurisë të deputetëve, Megjithatë rikujton se, në bazë të LDKP-së, përmbajtja e çdo formulari i duhet vënë në dispozicion një pale të interesuar vetëm me *kërkesë të tij/saj*. Ndërkohë që GRECO është siguruar se procedura e deklarinimit tashmë është lehtësuar dhe normalizuar duke hequr tarifën administrative dhe kontrollin paraprak të detyruar, nuk ka konstatuar ndonjë të dhënë për ndryshime në kuadrin ligjor, qoftë ky primar apo dytësor, që do të kërkonte që formularët e regjistruar në lidhje me 140 deputetët, të vihen menjëherë në dispozicion të publikut, në një faqe elektronike zyrtare, duke i kushtuar vëmendjen e duhur privatësisë dhe sigurisë së deputetëve dhe personave të lidhur me ta, që janë subjekt i detyrimit për deklarinim. GRECO rrjedhimisht nxit autoritetet për krijimin e një mjeti të tillë deklarinimi pa vonesa të mëtejshme.
28. GRECO arrin në përfundiminse rekomandimi iv është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi v.

29. *GRECO rekomandon që i) deklaratat e pasurisë së deputetëve t'u nënshtrohen kontrolleve të plota më të shpeshta; dhe ii) të rritet bashkëpunimi mes Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurisë dhe institucioneve të tjera shtetërore të përfshira.*
30. Në lidhje me pjesën (i) të rekomandimit, autoritetet e Shqipërisë u referohen projekt-ndryshimeve ligjore të LDKP-së dhe, në mënyrë specifike, Nenit 25 të tij. Aktualisht, ky nen parashikon kryerjen e kontrolleve të plota të deklaratave të pasurisë së deputetëve çdo tre vjet⁶, ndërsa drafti propozon rritjen e shpeshtësisë së kontrolleve në çdo dy vite. Ndryshimet ligjore do të miratohen vetëm pas përfundimit të reformës gjyqësore, e cila do të ndryshojë titujt e disa institucioneve gjyqësore referuar në LDKP, e që kërkon ndryshime të kushtetutës (shiko më poshtë).
31. Në lidhje me pjesën (ii) të rekomandimit, janë nënshkruar memorandume mirëkuptimi midis ILDKPIK-së dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm dhe Anti-Korrupsionit pranë Zyrës së Kryeministrit (Shtator 2014), Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (Dhjetor 2014), Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (Janar 2015), Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Qershor 2015), Policisë së Shtetit (Korrik 2015), FIU-t (2015), Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit (Dhjetor 2015) dhe Ministrisë së Financave (Shkurt 2016). Sa i takon ndikimit të këtyre masave, autoritetet këmbëngulin se, për të parën herë, janë çuar në Prokurori për procedim penal një numër i konsiderueshëm dosjesh për zyrtarë të nivelit të lartë, përfshirë 7 deputetë, si dhe 14 gjyqtarë (përfshirë një anëtar të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Kryetarin e Gjykatës së Apelit të Tiranës) dhe 2 prokurorë. Për disa deputetë janë marrë masa administrative (p.sh. gjoba).
32. Në lidhje me pjesën (i) të rekomandimit, GRECO kujton se kohëzgjatja e mandatit të deputetit është katër vite dhe se, në Raportin e Vlerësimit, e kishte konstatuar të pamjaftueshëm intervalin tre-vjeçar mes kontrolleve të plota të pasurive të deputetit për identifikimin e çdo lloj shpërdorimi të mundshëm të regjimit të

⁶GRECO vëren se, në lidhje me deputetët dhe ministrat, deklaratat i nënshtrohen kontrollit të plotë çdo dy vjet.

deklarimit të pasurisë, pa harruar po ashtu edhe procedurën disi të gjatë të ILDKPIK-së. Rrjedhimisht ai mirëpret amendamentet e propozuara për LDKP-në ku do të parashikohen kontrole të plota më të shpeshta të pasurisë së deputetëve. Megjithatë, për sa kohë ndryshimet ligjore janë vetëm në formë drafti, GRECO nuk mund të mbërrijë në një përfundim që kjo çështje është shqyrtuar qoftë edhe vetëm pjesërisht.

33. Duke iu kthyer pjesës (ii) të rekomandimit, nënshkrimi i protokolleve, i cili synon forcimin e bashkëpunimit midis ILDKPIK-së dhe një numri institucionesh, përfshirë autoritetet tatimore, është një zhvillim pozitiv që, siç evidentohet nga statistikat e paraqitura nga autoritetet, ka çuar në një numër domethënës referimesh penale dhe masash administrative të marra jo vetëm në lidhje me deputetët, por edhe për zyrtarë të tjerë publikë për shkelje të detyrimit të tyre ligjor për deklarim të pasurisë. GRECO arrin në përfundimin se kjo pjesë e rekomandimit është zbatuar kënaqshëm.
34. GRECO arrin në përfundiminse rekomandimi v është zbatuar pjesërisht.

Parandalimi i korrupsionit në lidhje me gjyqtarët

35. Autoritetet shprehen se, në gjysmën e dytë të vitit 2015, Shqipëria ka nisur një reformë themelore të sistemit të drejtësisë, e domosdoshme kjo për shkak të mungesës së cilësisë dhe koherencës në rregullimet ligjore dhe kushtetuese, nivelit të lartë të korrupsionit, integritetit të ulët dhe nivelit të ulët të profesionalizmit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, mungesës së mekanizmave efikasë të kontrollit dhe përgjegjësisë brenda gjyqësorit, mungesës së një ndarjeje të qartë të pushteteve midis organeve qeverisëse të sistemit gjyqësor dhe ndikimit të shpërpjesëtuar të politikës mbi drejtësinë. Projekt-amendamentet e Kushtetutës u botuan në Tetor 2015 dhe janë debatuar gjerësisht. Këto përfshijnë *inter alia* dispozitat për "Vlerësimin kalimtar të kualifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve", të cilat parashikojnë procesin e vetingut për të *gjithë* gjyqtarët dhe prokurorët. Paraqitja formale e amendamenteve kushtetuese përpara parlamentit është e afërt dhe varet nga përfshirja e sugjerimeve të bëra nga komisioni i Venecias në Opinionet e tij të përkohshme dhe përfundimtare mbi projekt-amendamentet kushtetuese të rishikuara për gjyqësorin⁷.
36. Megjithëse ndryshimet kushtetuese, të hartuara në Tetor 2015, u shqyrtuan nga GRECO, ai nuk është gjendje të familjarizohet me ndryshimet më të vona pasi reforma vazhdon dhe paraqiten ndryshime ligjore në mënyrë vazhdueshme.

Rekomandimi vi.

37. *GRECO rekomandon që i) përzgjedhja dhe emërimi i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë të jenë transparentë dhe në këto procese të kërkohet opinioni i gjyqësorit (p.sh., i vetë Këshillit të Lartë të Drejtësisë); dhe ii) vlerësimi periodik i veprimtarisë profesionale dhe etike të një gjyqtari të kryhet në kohën e duhur dhe t'i kushtohet vëmendje sigurimit që kriteret për vlerësimin e sjelljes etike të gjyqtarit të jenë objektive dhe transparente, duke respektuar parimin e pavarësisë së gjyqësorit.*
38. Në lidhje me pjesën (i) të rekomandimit, autoritetet e Shqipërisë u referohen ndryshimeve të vitit 2014 në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë". Këto dispozita kërkojnë që njoftimet për vendet e lira të botohen në faqen e internetit të kësaj Gjykate dhe të Presidentit të Republikës dhe se lista e

⁷Opinion i Përkohshëm u miratua në Dhjetor 2015 ([http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2015\)045-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2015)045-e)) dhe Opinion përfundimtar u miratua në 11 Mars 2016 ([http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2016\)009-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)009-e)).

kandidatëve të përshtatshëm të publikohet në faqen e internetit të këtij të fundit brenda një jave nga afati i aplikimeve. Është krijuar një Këshill i Emërimeve të Gjykatës së Lartë, i përbërë nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Ministri i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm, Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), Kryetari i Dhomës së Avokatëve dhe një gjyqtar i Gjykatës së Lartë i zgjedhur nga kolegët e tij/saj. Ai është një organ këshillues kolegjal në varësi të Presidentit të Republikës me detyrë verifikimin e pranueshmërisë së kandidatëve. Në fund të këtij procesi, Këshilli duhet të përgatisë një raport (i miratuar me shumicë vote) dhe të bëjë renditjen e kandidatëve që kualifikohen për rekrutim. Raporti i dërgohet më pas Presidentit të Republikës i cili duhet ta publikojë në faqen e internetit. Meqenëse, që nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore, nuk është shpallur ende asnjë vend i hapur në Gjykatën e Lartë, procedura e re nuk është testuar ende në praktikë.

39. Autoritetet tërheqin po ashtu vëmendjen në lidhje me reformën gjyqësore në proces e sipër dhe projekt-ndryshimet kushtetuese. Këto parashikojnë që gjyqtarët e Gjykatës së Lartë do të emërohen nga Presidenti i Republikës bazuar në një propozim të KLD-së, sipas një procedure transparente përzgjedhjeje bazuar në kritere objektive dhe të matshme⁸. Kështu KLD-ja do të marrë kompetencën për verifikimin e kritereve dhe për të vlerësuar e emëruar kandidatë të përshtatshëm.
40. Për pjesën (ii) të rekomandimit, autoritetet raportojnë se në vitin 2014 KLD-ja përfundoi raundin e parë të vlerësimit të gjyqtarëve. Raundi i dytë po zhvillohet dhe mbulon periudhën 2007-2009. Deri në 3 Mars 2016, KLD-ja kishte nxjerrë vlerësimet në lidhje me 186 gjyqtarë nga 316 gjyqtarët që i janë nënshtruar kësaj procedure, vlerësimet për 46 gjyqtarët e tjerë ishin në pritje, 21 gjyqtarë ishin përjashtuar nga kjo procedurë për arsye të ndryshme, vlerësimet për 15 gjyqtarë po finalizoheshin nga Kryeinspektori, 43 vlerësime të tjera po përgatiteshin, dhe për 7 gjyqtarë po grumbulloheshin dokumentacione mbështetëse në gjykatat përkatëse. Ky raund vlerësimi do të mbyllet në Mars 2016. Raundi i tretë aktualisht është në proces e sipër dhe duhet të përfundojë në fund të 2016; bërja e raundit të katërt që mbulon periudhën midis 2010 dhe 2012 varet nga rezultati i reformës gjyqësore. Veç kësaj, janë kryer për herë të parë edhe analiza të performancës, bazuar në kriteret specifike të miratuara nga KLD-ja, në lidhje me tridhjetë e shtatë kryetarë gjykatash dhe inspektorë gjykatash. Deri në 3 Mars 2016, kishte përfunduar analiza për një kryetar gjykate, për tre të tjerë vlerësimet i ishin dërguar KLD-së, ishin hartuar tre vlerësime të tjera, dhe në rastin e kryetarëve të gjykatave ishin mbledhur dokumente mbështetëse në gjykatat përkatëse.
41. Të gjitha vlerësimet janë bërë në përputhje me kriteret e vendosura nga KLD-ja në vitin 2010 - në veçanti, me parimin e pavarësisë. Veç kësaj i bëhet referencë edhe projektligjit "Për vlerësimin e gjyqtarëve" i cili iu paraqit parlamentit në vitin 2015, si pjesë e paketës së reformës kushtetuese dhe në drejtësi. Sipas kësaj, çdo gjyqtar do të vlerësohet çdo tre vjet në bazë të këtyre kritereve: kapaciteti, shprehjet organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimi profesional. Teksti i Nenit 10 të tij jepet më poshtë:

⁸Në veçanti, vendimet e KLD-së për emërimin e gjyqtarëve kandidatë do të miratohen me shumicë të cilësuar, pas një vlerësimi formal; nëse një kandidaturë hidhet poshtë, Presidenti i Republikës do të duhet të japë arsyet për atë vendim, dhe në rast mosveprimi nga Presidenti brenda një periudhe të specifikuar, kandidati i propozuar nga KLD-ja do të konsiderohet i zgjedhur.

Projektligj "Për vlerësimin e gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë"

Neni 10 - Etika dhe angazhimi ndaj vlerave gjyqësore

1. Me anë të këtij kriteri matet aftësia e gjyqtarit për të treguar etikë pune, integritet dhe paanësi.
2. Etika e punës e gjyqtarit në kuptimin e angazhimit dhe përgjegjshmërisë në detyrë, matet me anë të treguesve të nxjerrë nga burimet e vlerësimit si rezultatet e ankesave dhe verifikimet e tyre, opinioni i kryetarit të gjykatës dhe dënimet disiplinore përfundimtare brenda periudhës së vlerësimit për këtë gjë.
3. Integriteti i gjyqtarit në kuptimin e imunitetit të gjyqtarit ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm matet përkundër treguesve të tillë si rezultatet e ankesave dhe verifikimit të tyre, opinioni i kryetarit të gjykatës dhe dënimet disiplinore përfundimtare brenda periudhës së vlerësimit për këtë gjë.
4. Paanësia në kuptimin e kujdesit të gjyqtarit ndaj konflikteve të interesit dhe respektimit të problematikës së grupeve vulnerabël, si dhe në lidhje me çështjet gjinore dhe të minoriteteve. Kjo aftësi matet me anë të treguesve, si përdorimi i gjuhës diskriminuese ose numri jashtëzakonisht i lartë i kërkesave të palëve, të pranuar, për tërheqjen e gjyqtarit, si dhe duke përdorur edhe tregues të tjerë të nxjerrë nga burime të tjera të vlerësimit.

42. Përfundimisht, autoritetet tregojnë se, në vitin 2014, ka pasur vetëm një rast ku një gjyqtar kishte apeluar vlerësimin e miratuar nga KLD-ja përpara një gjykate administrative; në v. 2015, ishin regjistruar vetëm tre raste të tilla.
43. GRECO kujton se qëllimi parësor i pjesës (i) të rekomandimit ishte *inter alia* të depolitizonte përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, pasi ajo ka kompetencën të dëgjojë, si gjykatë e shkallës së parë, rastet gjyqësore në lidhje me zyrtarë të nivelit të lartë. Rrjedhimisht, ndryshimi i procedurës, sipas të cilës gjyqtarët e Gjykatës së Lartë tani emërohen nga Presidenti i Republikës bazuar mbi një përzgjedhje dhe renditje jo-detyruese të Këshillit për Emërimet e Gjykatës së Lartë (e jo nga Presidenti me pëlqim të Parlamentit) është në përgjithësi një zhvillim i mirëpritur, siç është edhe transparenca e rritur e procedurës së përzgjedhjes/emërimit të përcaktuar në ligj. Megjithatë, organi i ri këshillues kolegjal, edhe pse ka një përbërje të gjerë dhe përfshin disa përfaqësues të gjyqësorit, ka vetëm një përfaqësues të KLD- i cili vepron *ex officio*. Gjithashtu, në mungesë të informacionit për çështje si procesi i votimit, kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë në Këshill, modalitetet e formimit të buxhetit të Këshillit dhe procedura që duhet ndjekur në rast se Presidenti i Republikës justifikon hedhjen poshtë të kandidatit/ve të nominuar nga Këshilli, nuk është mundur të sigurohet nëse procedura është mjaftueshëm e mbrojtur nga konfliktet e mundshme të interesit dhe presioni i papërshtatshëm. Veç kësaj, jo vetëm që procesi i përzgjedhjes/emërimit nuk është zbatuar në praktikë, por ai shpejt do të zëvendësohet nga një tjetër mënyrë organizimi ku përgjegjësia për përzgjedhjen/emërimin e kandidatëve do t'i kalojë ekskluzivisht KLD-së⁹ (ai do të ketë gjithashtu një përbërje të re dhe kompetenca të reja substanciale). Megjithëse një reformë e tillë do të ishte plotësisht në përputhje me rekomandimin, nisur nga faza e hershme e procesit legjislativ, është e parakohshme të nxjerrësh një konkluzion përfundimtar në lidhje me përshtatshmërinë e saj. Kjo pjesë e rekomandimit, rrjedhimisht, konsiderohet si pjesërisht e zbatuar. Në të njëjtën kohë GRECO vëren se reformat kushtetuese do t'i heqin Gjykatës së Lartë kompetencën për të gjykuar - si gjykatë e shkallës së parë - rastet në lidhje me zyrtarë të nivelit të lartë; se cila gjykatë do ta marrë këtë kompetencë kjo mbetet për t'u parë.

⁹GRECO vëren se, në përputhje me projekt-ndryshimet në kushtetutë, do të krijohet një Gjykatë e re e Lartë Administrative dhe gjyqtarët e saj do të përzgjidheshin, dhe emëroheshin në të njëjtën mënyrë si gjyqtarët e Gjykatës së Lartë.

44. Në lidhje me pjesën (ii) të rekomandimit, GRECO nuk është në gjendje të shënojë ndonjë progres domethënës. Siç del nga sa më lart, intervali kohor domethënës mes vlerësimit dhe periudhave të referencës nuk është shkurtuar dhe kërkesave etike të zbatueshme u është bërë një interpretim i ngushtë. Duke pasur parasysh që shqetësimi i vazhdueshëm publik në lidhje me integritetin e gjyqtarëve ka qenë nxitësi parësor i reformës gjyqësore, do të ishte thelbësore transformimi i vlerësimeve periodike në një instrument të besueshëm të aftë për parashikimin, parandalimin dhe kapjen në mënyrë të besueshme të çdo shenje sjelljeje të keqe të një gjyqtari në një mënyrë efikase dhe në kohën e duhur. Gjithashtu, për sa kohë performanca e një gjyqtari vazhdon të matet me numrin/rezultatet e ankesave dhe numrin e dënimeve disiplinore përfundimtare brenda periudhës së referencës, jo me respektimin e Kodit të Etikës Gjyqësore¹⁰, nuk do të plotësohej objektivi themelor i vlerësimit, i cili duhet të ishte rikonfirmimi i faktit se çdo gjyqtar ka "cilësitë e larta morale" të kërkuara.
45. Statistikat për apelimet nuk janë informuese pasi në kohën e miratimit të Raportit të Vlerësimit, performanca e vetëm tre gjyqtarëve që vlerësuar si "e pranueshme" dhe asnjë gjyqtar nuk ishte konsideruar "i paafte"¹¹. Situata nuk ka të ngjarë të ketë ndryshuar që atëherë dhe ka mundësi që kjo shpjegon - të paktën pjesërisht - përse autoritetet po parashikojnë futjen e procedurës së jashtëzakonshme të vetingut. Edhe pse kjo shkon përtej fushës së këtij rekomandimi, GRECO vë në dukje një propozim për t'i nënshtuar të gjithë gjyqtarët (dhe prokurorët) ndaj një procedure për vlerësimin e profesionalizmit të tyre, të aseteve dhe lidhjeve me botën e krimit, realizimi i të cilës duhet bërë nga komisione të pavarura të kualifikimit (KPK) të krijuara enkas për këtë qëllim.
46. GRECO arrin në përfundiminse rekomandimi vi është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi vii.

47. *GRECO rekomandon që i) "Komisionii Etikës, verifikimit të mandateve dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional" në varësi të Konferencës Gjyqësore Kombëtare të përmbushë mandatin e tij dhe të sigurojë, në një mënyrë proaktive, zbatimin e rregullave të etikës; dhe se ii) gjyqtarëve t'u sigurohet udhëheqje, këshillim dhe trajnim i detyrueshëm në punë në lidhje me etikën, konfliktin e interesit dhe parandalimin e korrupsionit në radhët e tyre.*
48. Në lidhje me pjesën (i) të rekomandimit, autoritetet e Shqipërisë raportojnë se, në 2014-2015, "Komisioni i Etikës, verifikimit të mandateve dhe zhvillimit të vazhduar profesional" në varësi të Konferencës Gjyqësore Kombëtare, me kërkesë të Inspektoratit në varësi të KLD-së, miratoi tetë opinione këshilluese dhe disa "rekomandime" mbi pajtueshmërinë e sjelljes së gjyqtarëve të caktuar me Kodin e Etikës Gjyqësore. Megjithatë, për momentin, për sa kohë nuk janë bërë ndryshime në Ligjin "Për Konferencën Gjyqësore Kombëtare" apo në Kod, Komisionido të vazhdojë të luajë vetëm rol këshillues, i cili kufizohet me lëshimin e rekomandimeve dhe dhënie këshillash me kërkesë të Inspektoratit, Ministrin të Drejtësisë apo të gjyqtarëve individualë, ose në rast se veprimet apo veprimtaria e një gjyqtari bie ndesh me Kodin. Për pasojë, Komisioni nuk disponon aktualisht instrumentet që do të mundësonin ndjekjen nga ana e tij në mënyrë proaktive, të vazhdueshme dhe efektive të zbatimit të Kodit. Sipas kuadrit ligjor aktual, kompetencat mbikëqyrëse në këtë fushë, u mbeten kryetarëve të gjykatave dhe, nëse del një rast papajtueshmërie me rregullat e etikës, kjo i duhet paraqitur për inspektim të mëtejshëm një Inspektori të KLD-së.

¹⁰Kodi i Etikës Gjyqësore u miratua nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare në vitin 2000 dhe është ndryshuar në v 2006 (shih paragrafi 85 i Raportit të Vlerësimit).

¹¹Shiko paragrafin 73 të Raportit të vlerësimit.

49. Në lidhje me pjesën (ii) të rekomandimit, autoritetet u referohen iniciativave të mëposhtme të ndërmarra apo të parashikuara nga Shkolla e Magjistraturës si autoriteti përgjegjës për trajnimin gjatë punës të gjyqtarëve: 1) një kurs trajnimi i ri 72-orësh, i detyrueshëm për etikën profesionale për magjistratët e vitit të parë; 2) organizimi në vitin 2015 i katër seancave trajnuese të detyrueshme për etikën profesionale për gjyqtarët erinj dhe ata me përvojë pune (dhe prokurorë)¹²; 3) organizimi i planifikuar në Shkurt 2016 i tri seancave trajnuese për etikën profesionale me magjistratë kandidatë dhe gjyqtarë të emëruar; 4) organizimi i planifikuar në 2016 i dy seancave trajnuese për gjyqtarë (dhe prokurorë) për vlerësimin profesional dhe etik; dhe 5) pjesëmarrja e përfaqësuesve të KLD-së, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë në një trajnim të organizuar nga ILDKPKI për "autoritetet përgjegjëse" sipas përcaktimit në LDKP (Nëntor 2014, shih paragrafi 16).
50. Në lidhje me pjesën (i) të rekomandimit, GRECO është i zhgënjyer nga mungesa e hapave të prekshëm. Ai kujton se Komisioni i i Etikës, "rojtari" zyrtar dhe organi përgjegjës për interpretimin e Kodit të Etikës Gjyqësore, ka pasur për vite të tëra një profil të ulët, duke e reduktuar rolin e tij në lëshimin e certifikatave të etikës profesionale për gjyqtarët në lidhje me procesin e promovimit, me kërkesë të tyre, ose në rast kërkesë nga organe të tjera gjyqësore mbi të cilët opinionet e Komitetit nuk kanë një efekt detyrues. Mungesa e vazhduar e pronësisë së Kodit, veçanërisht fakti që Komisioni nuk reagon ndaj shkeljeve të Kodit në mënyrë proaktive, siç e kërkon Neni 12 i Ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare", dhe ndarja e funksionit mbikëqyrës mes disa organeve (Komisioni i Etikës, kryetarët e gjykatave dhe inspektorët e KLD-së) është një burim shqetësimi i vazhdueshëm. Veç kësaj, GRECO i kushton vëmendje një propozimi për t'i kaluar KLD-së, si pjesë e reformës së sistemit të drejtësisë, përgjegjësinë për miratimin e rregullave të etikës profesionale dhe monitorimin e respektimit të tyre. Nuk është bërë e qartë nëse ky rregullim i ri do t'i japë fund mandatit të Komisionit të Etikës. GRECO nxit autoritetet që në kuadrin e reformës gjyqësore në proces, t'i japin prioritet zbatimit të rregullave etike të zbatueshme për gjyqtarët. Ai po ashtu, tërheq vëmendjen ndaj shumëfishimit të organeve me kompetenca të mbivendosura pasi ka të ngjarë të rikrijohet perceptimi se etika gjyqësore po neglizhohet sërish. GRECO arrin në përfundimin se kjo pjesë e rekomandimit nuk është zbatuar.
51. Duke iu kthyer pjesës (ii) të rekomandimit, GRECO mirëpret fillimin e një trajnimi gjatë punës mbi etikën profesionale për gjyqtarët, ku niveli i pjesëmarrjes është që tani mjaft i mirë. Ai arrin në përfundimin se kjo pjesë e rekomandimit është zbatuar pëlqyeshëm.
52. GRECO arrin në përfundiminse rekomandimi vii është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi viii.

53. *GRECO rekomandonte që i) me qëllimin për të siguruar mbrojtje ndaj ndërhyrjes arbitrare në administrimin e drejtësisë, shkalla e të drejtës së Ministrit të Drejtësisë për të analizuar funksionimin e shërbimeve gjyqësore dhe administratës së gjykatave, siç parashikohet në Nenin 31 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë" duhet të jetë e përcaktuar qartë; dhe se ii) kryetarëve të gjykatave përkatëse, përfshirë Kryetarin e Gjykatës së Lartë, u duhet dhënë e drejta për të iniciuar procedurën disiplinore ndaj gjyqtarëve.*
54. Autoritetet e Shqipërisë u referohen projekt-ndryshimeve më të fundit kushtetuese të cilat parashikojnë krijimin e një institucioni të ri e të pavarur të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (HLD) me autoritetin për të hetuar mbishkeljet disiplinore dhe

¹²Në periudhën 2014-2015, këto trajnime janë ndjekur nga 40 gjyqtarë gjithsej.

ankesat ndaj të gjithë gjyqtarëve (përveç atyre të Gjykatës Kushtetuese) dhe prokurorëve dhe për të inspektuar gjykatat dhe prokuroritë. Kreu i institucionit do të zgjidhet nga parlamenti (mënyra e saktë e procedurës së votimit mbetet për t'u vendosur) nga një listë kandidaturash të propozuara nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (një organ i ri i cili krijohet në bazë të Kushtetutës së rishikuar) dhe do të ketë statusin e një gjyqtari të Gjykatës së Lartë. Ngritja e kësaj strukture të re pritet të zgjidhë konfliktin aktual institucional mes Ministrit të Drejtësisë dhe Inspektoratit të KLD-së, ndërkohë që përqendron kompetencat e inspektimit tek një organ dhe siguron një përdorim më eficient të burimeve njerëzore të kufizuara.

55. Vendimi për vendosjen apo jo të një mase disiplinore për gjyqtarët do të merret nga KLGj, dhe për anëtarët e KLGj-së nga Tribunali i Lartë Disiplinor. Ky i fundit do të shqyrtojë po ashtu edhe apelimet ndaj masave disiplinore të vendosura nga KLGj. Tribunali do të përbëhet nga Kryetarët dhe një anëtar i lartë i Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Lartë Administrative si dhe nga Prokurori i Përgjithshëm dhe Kryetari i Dhomës së Avokatisë. Në lidhje me gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, ligji organik i Gjykatës përcakton një procedurë disiplinore specifike dhe në rast provimi të sjelljes së papranueshme, masa e vetme e zbatueshme është shkarkimi nga detyra.
56. GRECO vë në dukje informacionin mbi projekt-ndryshimet më të fundit në Kushtetutë, të cilat nuk ishte në gjendje t'i shqyrtonte. Ndërkohë që parashikimi për transferimin e përgjegjësisë për inspektimin e gjykatave nga Ministria e Drejtësisë tek Inspektori i pavarur i Drejtësisë mund të konsiderohet - në përgjithësi - si një hap pozitiv, nuk është përcaktuar fusha e saktë e këtyre inspektimeve, nuk është qartësuar e drejta e inspektorit për të kryer inspektimet kryesisht (*ex officio*) dhe, çka është më e rëndësishme, është e paqartë nëse Ministrit të Drejtësisë i është hequr kompetenca për kryerjen e këtyre inspektimeve paralelisht. Situata ndërlikohet nga e drejta e Ministrit për të "inspektuar" aktivitetet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjë që, nisur nga statusi i këtij të fundit si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, duket problematike. Në lidhje me pjesën (ii) të rekomandimit, GRECO kujton se, në kohën e vlerësimit, Ministri i Drejtësisë kishte të drejtën ekskluzive për të iniciuar procedurën disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe se kjo shihej si diçka që krijonte mundësi të mëdha për influencë të papërshtatshme. Ndërkohë që ndryshimet kushtetuese pranohet se sigurojnë një procedurë të balancuar, sipas të cilës fuqia e "akuzuesit" i jepet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të pavarur (në projekt-ndryshimet e mëparshme kushtetuese, Inspektorati ishte konceptuar si një organ kolegjal) dhe funksioni vendimmarrës i jepet KLGj-së, statusi i Ministrit të Drejtësisë si një "kërkues i privilegjuar" në lidhje me hetimin e një shkeljeje disiplinore të prezumuar të një gjyqtari, duket se krijon diskriminim në raport me kërkues të tjerë, pasi Inspektori duket të ketë një lloj hapësire gjykimi në lidhje me atë nëse duhet të reagojë apo jo ndaj ankesave të këtij të fundit. GRECO pret që këto shqetësime të adresohen nga reforma në proces. Duke pasur parasysh fazën e hershme të procesit legjislativ dhe një sërë çështjesh të rëndësishme që presin zgjidhje, ky rekomandim vlerësohet si pjesërisht i zbatuar.
57. GRECO arrin në përfundiminse rekomandimi viii është zbatuar pjesërisht.

Parandalimi i korrupsionit në lidhje me prokurorët

Rekomandimi ix.

58. *GRECO rekomandonte përpunimin e mëtejshëm të kriterëve për vlerësimin e cilësive etike të prokurorit, veçanërisht duke siguruar që kriteret të jenë objektive dhe transparente.*
59. Autoritetet e Shqipërisë i referohen miratimit së fundi të Rregullave të etikës dhe sjelljes së prokurorëve (shih rekomandimi x) dhe implikimit që kjo gjë ka për

Sistemin e Vlerësimit Vjetor të Prokurorëve. Në mënyrë të veçantë, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, në konsultim me trupën e prokurorëve dhe strukturat e tjera të kësaj Zyre, ka hartuar ndryshimet mëposhtme për Rregulloren 2012 "Për Sistemin e Vlerësimit të Punës dhe të aftësive profesionale e morale të prokurorëve":

"Neni 40 – Cilësitë etike të prokurorit

Cilësitë etike përfshijnë këta elementë:

1. *Etika e prokurorit në ushtrimin e procedimit penal dhe pjesëmarrjen në seancat gjyqësore;*
2. *Respekti për të drejtat e individit, trajtimi i barabartë dhe shmangia e çdo lloj diskriminimi apo paragjykimi në lidhje me palët dhe subjektet e procedurës penale;*
3. *Mbrojtja e të dhënave konfidenciale dhe personale të palës së dëmtuar, dëshmitarit, etj. sidomos në rastin e të miturve;*
4. *Mospërdorimi i informacionit të siguruar për shkak të detyrës për interes personal apo palë të treta.*
5. *Përgjegjësia e prokurorit në administrim për të menaxhuar dhe mbajtur aktet procedurale, provat, objektet e konfiskuara, etj.*
6. *Paraqitja formale dhe serioze në komunikim dhe veshje".*

"Neni 41 - Integriteti dhe shmangia e konflikteve të interesit

Integriteti dhe shmangia e konflikteve të interesit përfshijnë këta elementë:

1. *Qëndrimi ndaj presioneve dhe ndikimeve të jashtme;*
2. *Vëmendja ndaj konfliktit të interesit dhe ndalimi i përfitimeve apo trajtimeve preferenciale për shkak të funksionit;*
3. *Heqja dorë ose dhënia e mundësisë palëve për të kërkuar përjashtimin e prokurorit nga çështja në rast se ka ndonjë arsye anësie.*
4. *Kryerja e veprimtarive jashtë (punës) në përputhje me kërkesat ligjore*
5. *Kujdesipër të mbrojtur imazhin e prokurorit jashtë kohës së punës*

Autoritetet shprehen më tej se këta elementë të rinj janë integruar tashmë në një draft-formular të vlerësimitvjetor në seksionin IV - "aftësitë organizative"¹³ (Seksionin IV-3 dhe IV-4) i shoqëruar me kritere të qarta vlerësuese (shih Shtojca 1).

60. Në opinionin e GRECO-s, rishikimi i rregullave të brendshme për vlerësimin e rregullt të performancës së prokurorëve, me synimin për të përcaktuar më mirë integritetin dhe cilësitë e tyre etike, përbën një zhvillim pozitiv dhe është një hap në drejtimin e duhur, veçanërisht kur krahasohet me dispozita të ngjashme të vendosura në lidhje me gjyqtarët (shiko paragrafin 41). Megjithatë, siç është e qartë nga teksti i sipërcituar dhe nga draft-formulari bashkangjitur si shtojcë, kriteret e përpunuara janë kufizuar në një numër të vogël elementësh të konsideruar si kyç për përmbushjen e funksionit procedues. Ndërkohë që rëndësia e tyre nuk vihet në pyetje, do të ishte e dëshirueshme të bëhej lidhja e tyre në mënyrë më eksplicite me "cilësitë e larta morale" që një prokuror pritet të ketë. GRECO kujton se "cilësitë e larta morale" janë një kërkesë e përgjithshme për emërimin dhe promovimin e prokurorëve. Ajo u referohet gjithashtu edhe Rregullave të etikës të miratuara rishtazi dhe disi të përgjithshme, që janë detyruese për të gjithë prokurorët dhe parashikojnë masa disiplinore për shkelje (shih rekomandimi x). GRECO mbron pikëpamjen se vlerësimi periodik i

¹³Vlerësimi përmban 6 module kryesore: aftësitë profesionale (Seksioni I), Aftësitë personale (Seksioni II), Kapacitetet dhe pozicioni social (Seksioni III), Aftësitë organizative (Seksioni IV), Respekti për disiplinën në punë (Seksioni V) dhe masat disiplinore (Seksioni VI).

suksesshëm duhet të jetë i kushtëzuar me respektimin e këtyre Rregullave, që kjo të jetë e artikuluar qartë e se instrumenti i vlerësimit të performancës të përshtatet në mënyrë që të konstatojë pajtueshmërinë me standardet etike të zbatueshme apo dështimin në zbatimin e tyre. Autoritetet rrjedhimisht inkurajohen për të çuar më tej përpjekjet e tyre për të gjetur balancën e drejtë midis përshkrimit të detajuar, siç mishërohet tek Rregullat, dhe një kuadri vlerësimi mjaftueshëm fleksibël që do të ishte i aftë për të hedhur dritë mbi çdo çështje që potencialisht bie brenda fushës së veprimit të ligjit. GRECO arrin në përfundimin që ky rekomandim është zbatuar pjesërisht.

61. GRECO arrin në përfundimin që rekomandimi ix është zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi x.

62. *GRECO rekomandonte që i) të përpunohej dhe të zbatohet në mënyrën e duhur një paketë standardesh etike të qarta/kod i sjelljes profesionale të zbatueshme për të gjithë prokurorët; dhe ii) prokurorëve t'u ofrohej udhëheqje dhe trajnim i detyruar gjatë punës mbi etikën, konfliktin e interesit dhe parandalimin e korrupsionit në radhët e tyre.*
63. Në lidhje me pjesën (i) të rekomandimit, autoritetet konstatojnë se në 19 Qershor 2014, me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm u miratuan Rregullorja e re e Etikës dhe Sjelljes së prokurorëve. Procedura e miratimit përfshinte *inter alia* fazat e mëposhtme: 1) mbështetja e ekspertëve gjatë gjithë procesit; 2) një workshop për të gjithë zyrat e prokurorisë (7-8 Prill 2014); 3) debat në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm (20 Qershor 2014); dhe 4) shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i Prokurorëve. Rregullorja është ndërtuar në katër kapituj¹⁴ dhe përcakton parimet, normat dhe udhëzimet që kanë për qëllim të sigurojnë dhe garantojnë profesionalizmin, pavarësinë, paanësinë, ndershmërinë, integritetin dhe korrektesën e prokurorëve në ushtrimin me efektshmëri të funksioneve të tyre kushtetuese dhe ligjore, në interes të drejtësisë penale, dhe për të rritur besimin publik.
64. Një shkelje e rregullores, nëse nuk përbën shkelje penale, shërben si arsye për fillimin e një procedure disiplinore.¹⁵ Një Inspektor Etike, i caktuar nga Prokurori i Përgjithshëm, siguron respektimin e Rregullores dhe duhet të verifikojë një shkelje të mundshme *ex officio* ose brenda 10 ditësh nga marrja e njoftimit. Kontrollat mbyllen me një rekomandim drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm për të hapur procedurë penale ose disiplinore ose për të urdhëruar organizimin në vijim të një trajnimit të posaçëm. Inspektori vepron po ashtu në kapacitetin këshillues dhe u jep përgjigje të menjëhershme me shkrim prokurorëve që janë të pasigurt nëse një sjellje e caktuar mund të jetë apo jo shkelje e rregullave etike. Rregullorja është detyruese për të gjithë prokurorët dhe i detyron ata të bashkëpunojnë me Inspektorin dhe t'i raportojnë atij/asaj çdo keqveprim nga shefat, kolegët apo vartësit e tyre. Rregullorja u botua në formë broshure, e shpërndarë në të gjithë Shërbimin dhe mund të vizitohet në një faqe interneti zyrtare (www.pp.gov.al).
65. Autoritetet deklarojnë se Inspektori i Etikës ka trajtuar shumë raste të shkeljes së etikës, referuar atij drejtpërsëdrejti nga prokurorët apo nëpunësit e Shërbimit të Prokurorisë, apo ankesa të qytetarëve në lidhje me vendimet e prokurorisë. Inspektori ka nxjerrë rekomandime dhe ka ofruar këshillim në disa raste; në një rast ai ka iniciuar procedim disiplinor dhe në pesë raste hetimi vazhdon.

¹⁴Dispozita të përgjithshme, marrëdhënie institucionale dhe ndërinstitucionale, shkelje e rregullave dhe inspektimet për zbatimin e tyre dhe dispozitat përfundimtare.

¹⁵Kjo ka të bëjë edhe me rastet kur veprimet/sjellja e një prokurori nuk mbulohen në mënyrë eksplicite nga Rregullorja, por efekti që ato prodhojnë konsiderohet si ingjashëm me një shkelje të Rregullores.

66. Duke iu kthyer pjesës (ii) të rekomandimit, pas miratimit të Rregullores së Etikës, Bordi i Trajnimit në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm ka filluar trajnimin periodik të detyrueshëm për etikën e brendshme dhe çështje të integritetit për të gjithë prokurorët (ky trajnim plotësohet me trajnime të ngjashme të ofruara nga Shkolla e Magjistraturës). Autoritetet u referohen nismave të mëposhtme: 1) organizimi i trajnimit për Rregulloren e re¹⁶ për të gjithë prokurorët (Dhjetor 2014 – Prill 2015); 2) përfshirja e një kursi trajnimi dyditor për etikën dhe konfliktin e interesit në programin njëvjeçar të trajnimit gjatë punës për prokurorët; dhe 3) pjesëmarrja e përfaqësuesve të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm në trajnimin e organizuar nga ILDKPKI për "autoritetet përgjegjëse" sipas përcaktimit në LDKP (Nëntor 2014, shih paragrafi 16). Autoritetet shprehen më tej se në një aktivitet trajnimi ishte ftuar edhe një përfaqësues i një Shteti anëtar të GRECO-s, nisur nga përvoja pozitive e atij Shteti në këtë fushë.
67. GRECO lëvdon autoritetet për konceptimin e një procesi gjithëpërfshirës dhe të besueshëm i cili ka kulmuar me miratimin e Rregullores së Etikës për prokurorët. Rregullorja nuk është modeluar vetëm për të promovuar respektimin e standardeve të larta të sjelljes profesionale brenda Shërbimit, por edhe për të ofruar udhëheqje dhe për të rritur përgjegjshmërinë përmes një mekanizmi zbatues të integruar. Statistikat e dhëna tregojnë se ky mekanizëm po lëshon rrënjë dhe gradualisht po zbatohet në praktikë. GRECO është njëlloj i impresionuar me trajnimet e shumta menjëherë pas miratimit të Rregullores dhe është i kënaqur që tashmë programit njëvjeçar të trajnimit gjatë punës për prokurorët i është shtuar një kurs dyditor për etikën dhe konfliktin e interesit.
68. GRECO arrin në përfundiminqë rekomandimi x është zbatuar kënaqshëm.

III. Konkluzione

69. **Nisur nga sa më sipër, GRECO arrin në përfundimin se vetëm një nga dhjetë rekomandimet në Raportin e Vlerësimit të Raundit të Katërt është zbatuar apo trajtuar kënaqshëm nga Shqipëria.** Nëntë rekomandime janë zbatuar pjesërisht deri tani.
70. Në mënyrë më specifike, rekomandimi x është zbatuar kënaqshëm dhe rekomandimet i-ix janë zbatuar pjesërisht.
71. Në lidhje me deputetët, janë bërë disa hapa pozitivë drejt përmbushjes së rekomandimeve të GRECO-s. Është sqaruar momenti i publikimit të projektligjeve fillestare dhe janë krijuar disa instrumente për një menaxhim më të mirë të marrëdhënieve të deputetëve me përfaqësues të interesit publik dhe privat. Kodi i Sjelljes për deputetët është duke u përpunuar, është ngritur një mekanizëm i brendshëm për deklarimin *ad hoc* të konfliktit të interesit nga deputetët dhe kontrolli i pasurive të deputetëve është përmirësuar në mënyrë të argumentueshme falë një zbulimi të përsheptuar të formularëve të depozituar të deklaratës së pasurisë për palë të treta me kërkesë të tyre. Megjithatë, progresi i bërë ka qenë i pjesshëm dhe i fragmentuar dhe disa nga masat e raportuara kanë pasur si objektiv primar aktorë apo struktura të tjera, jo vetë deputetët. GRECO për këtë arsye rithekson urgjencën e futjes së Kodit të Sjelljes për deputetët dhe të rregullimit të kontakteve të tyre me lobistë dhe palë të treta që kërkojnë të ndikojnë mbi procesin legjislativ. Po ashtu, njoftimi "rast pas rast" i konfliktit të interesit nga deputetët duhet bërë një praktikë e rregullt e po kështu edhe shpeshtimi i kontroleve të plota të formularëve të depozituar të deklaratës së pasurisë dhe publikimi i menjëhershëm i tyre në faqen zyrtare të internetit.

¹⁶Trajnim *inter alia* për rolin këshillimor të Inspektorit të Etikës

72. Për sa u takon gjyqtarëve dhe prokurorëve, Shqipëria ka hyrë në një proces reformimi themelor të kushtetutës dhe sistemit të drejtësisë, i cili, nëse finalizohet, jo vetëm që do të bënte një rishikim total të të gjithë sistemit gjyqësor, por do të ndikonte të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, duke ia nënshtuar ata një procedure vetingu të paprecedent. Po ashtu, megjithëse reforma të caktuara të realizuara deri tani kanë prodhuar efekte pozitive të dukshme (p.sh. mënyra e re e përzgjedhjes/emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, hartimi i Rregullores së etikës dhe sjelljes së prokurorëve), iniciativa të tjera të raportuara ende nuk u përgjigjen të gjitha shqetësimeve në bazë të rekomandimeve të GRECO-s. Veçanërisht sistemi i papërshtatshëm për vlerësimet periodike të performancës së gjyqtarëve, kriteret e mangëta apo shumë të ngurta për vlerësimin e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe mungesa e vazhdueshme e zbatimit të rregullave etike veçanërisht në lidhje me gjyqtarët. GRECO ka besim se këtyre dhe çështjeve të tjera të rëndësishme do t'u kushtohet vëmendje e duhur gjatë reformës në vazhdim.
73. Duke pasur parasysh sa më sipër, GRECO vëren se, në mungesë të arritjeve vendimtare, është e domosdoshme të bëhet progres i mëtejshëm përmbajtësor domethënës për të treguar se është arritur një nivel i pranueshëm pajtueshmërie me rekomandimet brenda 18 muajve në vazhdim. Megjithatë, duke pasur parasysh që aktualisht janë në proces zhvillimi reforma thelbësore dhe duke besuar që autoritetet e Shqipërisë do të çojnë më tej përpjekjet e tyre, GRECO arrin në përfundimin që niveli aktual i ulët i përputhshmërisë me rekomandimet nuk është "tërësisht i pakënaqshëm" në kuptimin e Rregullit 31, paragrafi 8.3 i Rregullave të Procedurës të GRECO-s. GRECO fton Kryetarin e Delegacionit të Shqipërisë të paraqesë informacione shtesë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve i-ix deri në 30 Shtator 2017.
74. Përfundimisht, GRECO fton autoritetet e Shqipërisë të autorizojnë, sa më shpejt të jetë e mundur, publikimin e raportit, ta përkthejnë raportin në gjuhën kombëtare dhe përkthimin ta bëjnë publik.

Shtojcë 1

PROJEKT-FORMULAR PËR PROKURORËT

IV-3. Cilësitë etike të prokurorit
3.1 Përshkruaj dhe vlerëso aftësitë e komunikimit, sjelljen e denjë, gjykimin e ftohtë të prokurorit në ushtrimin e procedimit penal dhe në seancat gjyqësore.
3.2 Përshkruaj dhe vlerëso aftësitë e prokurorit në lidhje me të drejtat e individit, trajtimin e barabartë dhe shmangien e çdo lloj diskriminimi apo paragjykimi.
3.3 Përshkruaj dhe vlerëso aftësitë e prokurorit për të siguruar mbrojtjen e të dhënave konfidenciale dhe personale të palës së dëmtuar, etj.
3.4 Përshkruaj dhe vlerëso aftësitë e prokurorit për të siguruar mos-përdorimin e informacionit të siguruar për shkak të detyrës për interes vetjak apo për palë të treta.
3.5 Përshkruaj dhe vlerëso aftësitë e prokurorit për menaxhimin dhe ruajtjen e dosjeve, akteve procedurale, provave, objekteve të konfiskuara.
3.6 Përshkruaj dhe vlerëso aftësitë komunikuese të prokurorit në lidhje me eprorët, kolegët, vartësit dhe administratën.
3.7 Përshkruaj dhe vlerëso aftësitë e prokurorit në paraqitjen formale dhe serioze.

IV-3. Cilësia etike	Shumë mirë	Mirë	Mjaftues hëm	I paaftë
Aftësitë komunikuese në proces dhe jashtë tij				
Respektimi i të drejtave të individit dhe trajtimi i barabartë e jodiskriminues				
Mbrojtja e të dhënave personale				
Mospërdorimi i informacionit për interes vetjak				
Menaxhimi i materialit procedural, menaxhimi efektiv i kohës së punës				
Aftësitë komunikuese në marrëdhëniet me eprorët, kolegët, vartësit dhe administratën				
Paraqitja formale dhe serioze në veshje				

IV-4. Integriteti dhe shmangia e konfliktit të interesit
4.1 Përshkruaj dhe vlerëso aftësitë e prokurorit për të shmangur influencat nga faktorë të brendshëm e të jashtëm.
4.2 Përshkruaj dhe vlerëso aftësinë e prokurorit për të menaxhuar raste të papajtueshmërisë me funksionin sipas ligjit në fuqi, ndalimi i përfitimeve preferenciale, dhuratave apo çdo përfitimi tjetër për funksionin.
4.3 Përshkruaj dhe vlerëso aftësitë e prokurorit për të siguruar shmangien e konfliktit të interesit në rast se ka ndonjë arsye anësie në proces.

4.4 Përshkruaj dhe vlerëso veprimtarinë e aktiviteteve të jashtme të prokurorit sipas legjislacionit.
4.5 Përshkruaj dhe vlerëso kujdesin e prokurorit në ruajtjen e imazhit të pacenuar të prokurorit jashtë orarit të punës.

IV-4. Integriteti dhe shmangia e konfliktit të interesit	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	I paaftë
Qëndrimi ndaj presioneve dhe ndikimeve të brendshme dhe të jashtme				
Pajtueshmëria me funksionin				
Shmangia e konfliktit të interesit				
Aktivitetet jashtë punës së prokurorit				
Mbrojtja e imazhit të prokurorit jashtë orarit të punës				